

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E HËNË 5 SHTATOR 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju uroj të gjithëve një sesion të mbarë parlamentar, duke pasur në konsideratë që sfidat politike qeverisëse të këtij parlamenti, integruese dhe ato të sigurisë janë jashtëzakonisht të mëdha përballë gjithsecilit nga ne! Shqipëria po jeton kohë shumë të vështira, të cilat nuk janë vetëm ekonomike. Kushtetuta dhe ligji sot e kanë humbur vlerën. Pushteti dhe politika janë kthyer në qëllim në vetvete, ndaj si parlamentarë duhet të shikojmë cilat janë prioritetet tona.

Mendoj se kemi detyrime urgjente si parlamentarë që vijmë nga vota e qytetarëve shqiptarë, të garantojmë një reforme zgjedhore, e cila të sigurojë zgjedhje të lira e të ndershme, ku deputetët apo edhe këshilltarët të mos zgjidhen nga partitë politike, por të zgjidhen nga qytetarët nëpërmjet një gare dhe nga gara askush nuk ka keq, përveçse zhvillohet shoqëria dhe politika vetë. Po ashtu, të garantohet mundësia për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur nga të gjithë shqiptarët, kudo që ata jetojnë në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë. Një sfidë tjetër e rëndësishme është reforma territoriale, e cila duhet të ketë synim garantimin e zhvillimit të vendit në të gjithë territorin e saj.

Pushteti lokal dhe financat duhet të jenë pranë qytetarëve, të cilët duhet të vendosin, dhe jo në qendra qytetesh, në duart e kryetarëve dhe të pushteteve për interesa elektorale. Të nderuar kolegë deputetë, Parlamenti duhet t'i kthehet funksionit të tij kushtetues dhe jo të jetë një apendiks pa vlerë i qeverisë. Gjatë mbledhjes së fundit të Kryesisë së Kuvendit një kolege shtroi një shqetësim për sa i përket procesit ligjvënës në këtë Kuvend, ku shumë nga aktet ligjore nuk kanë kualitetin e nevojshëm, prandaj duhet të shtrojmë se sa autoritet dhe sa kapacitete ka ky parlament për të asistuar bindjet dhe nevojat e parlamentarëve si organ ligjvënës për të bërë ligjet e duhura në shërbim të elektoratit që e kanë votuar dhe në shërbim të interesave kombëtare.

Të nderuar kolegë,

Korrupsioni dhe krimi janë kthyer në sistem dhe dominojnë jetën publike. Institucionet ndërkombëtare në raportet e tyre e rendisin Shqipërinë ndër vendet më të varfra dhe me korrupsionin më të lartë. Shqipëria po përballlet me një krizë ekonomike që po bëhet e pandalshme, e paparashikueshme, e cila po varfëron dhe do të varfërojë shqiptarët dhe ekonomitë e tyre familjare. Kemi një krizë akoma më të rëndë dhe më të madhe, krizën e besimit të shoqërisë shqiptare, e cila reflektohet nga largimi masiv i shqiptarëve nga Shqipëria, në mënyrë të veçantë të rinjve dhe të rejave, intelektualëve dhe profesionistëve.

Kjo krizë jo vetëm po e varfëron dhe po e mplaq vendin tonë, por po krijon një problem të madh jo vetëm ekonomik, por edhe politik dhe shumë të rëndë social për të gjithë shoqërinë tonë dhe familjet shqiptare. Sot, për fatin e keq, nuk ka dallim ndërmjet krimit dhe biznesit, nuk ka dallim ndërmjet të mirës dhe të keqes, nuk ka dallim ndërmjet drejtësisë dhe padrejtësisë dhe, për fatin e keq, ne e frymëzojmë më shumë se kushdo tjetër këtë situatë. Sharja, fyerja dhe interesi i pushtetit dominon mbi interesin e qytetarëve, mbi interesat kombëtarë dhe mbi interesat e Shqipërisë.

Ekonomitë familjare dhe biznesi, duke konsideruar çmimet e larta dhe zhvillimet ekonomike, po njohin sfida jashtëzakonisht të mëdha, ndaj është detyrë primare e qeverisë të përcaktojë në mënyrë të shpejtë politikat në mbështetje të ekonomive familjare dhe të bizneseve, por sidomos avancimin më tej të investimeve në sektorin energjetik, situatë që do të jetë gjithnjë e më problematike. Këtu, të gjithë ne si deputetë duhet të dalim në një gjykim të përbashkët se cilën rrugë duhet të ndjekim për të garantuar zhvillimin e këtij sektori që u shërben interesave afatgjata të vendit. Hapëm pas shumë kohësh negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Europian, por, për fatin e keq, ende nuk po gjejmë kurajën për të punuar si politikanë, si politikë, si Kuvend dhe si qeveri për të afruar anëtarësimin në Bashkimin Europian nëpërmjet një pune të përbashkët.

Procesi i integritimit europian nuk është çështje trofeu politik, por është interesi i shqiptarëve dhe këtu duhet të jemi të gjithë së bashku, jo vetëm për të miratuar ligje, por për të implementuar ligje, për të çuar jetën e qytetarëve shqiptarë në standarde europiane. Ne jemi vend anëtar i NATO-s dhe duhet të sillemi si të tillë, duke ndërtuar një pozicion të qartë tonin

në raport me sfidat që kemi, me strategjitë tona të sigurisë kombëtare, duke u përshtatur me dokumentet strategjike të NATO-s. Rajoni ku ne jetojmë ka sfida jashtëzakonisht të mëdha të sigurisë, që unë nuk dua t'i përsëris, të cilat kërkojnë qartësi jo vetëm nga qeveria, por edhe nga ne si deputetë, në trajtimin e këtyre çështjeve.

Ka penetrim të fortë të forcave dhe vendeve, të cilat bien ndesh me interesin tonë kombëtar, ndaj edhe vëmendja jonë duhet të jetë jashtëzakonisht e madhe, në mënyrë që çdo zhvillim ekonomik, çdo qëndrim politik patjetër duhet të konsiderojë primar interesin tonë kombëtar. Ne, opozita, tej kësaj salle, kemi një detyrim akoma edhe më madhor: t'u rikthejmë besimin shqiptarëve dhe për ta bërë këtë duhet të vendosim të marrim pjesë bashkë me ta në ndryshimin e vendit, duke ndërtuar atë politikë që u takon shqiptarëve, sipas vlerave të traditës më të mirë shqiptare. Shqipëria ka me mijëra të rinj dhe të reja, intelektualë dhe profesionistë këtu, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Britani dhe në Europë, që mund të jenë parlamentarë të jashtëzakonshëm dhe qeveritarë shumë të zotë, të cilët mund ta bëjnë Shqipërinë vërtet europiane.

Meqenëse jemi në Ditën e Nënë Terezës, po ju kujtoj një thënie të saj: "Bashkimi rreth dashurisë, jo ndarja dhe urrejtja, e çon një komb përpara". Faleminderit!